
RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT

SI PASOJË E SHKELJEVE TË LIGJIT TË PROKURIMIT RREZIKOJMË TË HUMBIM MILIONA EURO

HYRJE

Institucionet dhe ndërmarrjet publike të Kosovës janë duke e dëmtuar me miliona euro buxhetin e shtetit për shkak të shkeljeve ligjore dhe të rregulloreve mbi prokurimin. Kjo po ndodhë për shkak të interesave të ndryshme, aferave korruptive dhe papërgjegjesisë së zyrtarëve. Kompania publike PTK mund t'i humbasë 16 milionë euro për shkak të një vendimi të nxituar të kësaj kompanie për lidhjen e një kontrate si dhe për shkak të reagimit të vonuar të qeverisë për anulimin e saj. Kjo kompani vazhdon të qëndrojë në top-listën e shkeljeve më të mëdha ligjore nga menaxhmenti i saj.

Edhe dikastere të ndryshme rrezikojnë të paguajnë qindra mijëra euro për shkak të mospërfilljes së procedurave dhe ligjeve në fuqi. Larg me shkelje nuk mbetet as Komuna e Prishtinës. Lëvizja FOL ka evidentuar vetëm disa prej tyre të cilat nuk duhet të përsëriten më.

PTK RREZIKON TË PAGUAJ 16 MILIONË EURO PËR SHKAK TË PAPËRGJEGJËSISË

Postë-Telekomi i Kosovës në prill të vitit të kaluar kishte lidhur kontratë që peshonte afro 20 milionë euro me kompaninë izraelite "Amodcs". Kjo kontratë ka paraparë krijimin e dy platformave të ndara të faturimit për njësinë e Telekomit dhe të telefonisë mobile "Vala". Kjo kompani në vitin 2008 sipas raportimeve në media kishte kërkuar 11 milionë euro nga Postë-Telekomi për krijimin e një platforme të përbashkët të faturimit të dy njësive "Vala"-s e Telekomit. Disa ditë pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet PTK-së e "Amdocs" kishte ndërhyrë Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë për Ekonomi e Financa e cila e kishte marrë vendim për shkëputjen e kontratës. Kjo ministri nuk kishte reaguuar më herët edhe pse kishte pasur tetë ditë në dispozicion pas shpalljes së fituesit për këtë projekt nga PTK-ja.

Kompania izraelite ka vendosur ta çojë lëndën në Gjykatën e Arbitrazhit në Londër duke kërkuar dëmshpërblim që kalon shumë prej 16 milionë eurove. PTK-ja ka ndarë një fond prej 300 mijë eurosh për t'i paguar avokatët që e përfaqësojnë në Londër. Kryetari i bordit të PTK-së ka deklaruar se kjo korporatë pret që mbrojtësit e kësaj korporate të zbresin dëmshpërblimin deri në 8 milionë euro.

PTK ka lidhur marrëveshje pa zhvilluar procedura të prokurimit me "Weltmender" nga Zvicra për të qenë operator virtual i pikave të shitjes. Kjo kompani ishte angazhuar për të hapur 2 mijë pika të shitjes për rimbushje elektronike për përdoruesit me parapagim. Nga shitja e mbushjeve elektronike, në bazë të kontratës 6 për qind të fitimit i takonte kompanisë private "Weltmender". Zyrtarët e PTK-së në deklarime për media nuk kanë mohuar që përfitimet e kompanisë në bazë të kësaj kontrate mund të jenë milionëshe. Ky veprim i kësaj ndërmarrjeje paraqet shkelje të ligjit të prokurimit i cili obligon autoritetet kontraktuese që për vlera të mëdha të tenderëve të zhvillojnë procedura të prokurimit.

SHKELJET NGA KOMUNA E PRISHTINËS

Komuna e Prishtinës në një tender për ndërtimin e një shkolle në Hajvali, vlera e të cilës kalonte shifrën prej 900 mijë eurosh, kishte bërë shkelje të Ligjit të prokurimit respektivisht nenit 50 i cili obligon autoritetet kontraktuese që të specifikojnë në dosjen e tenderit se kontrata do t'i jepet operatorit me ofertën me të lirë apo ekonomikisht më të favorshme. Komuna e Prishtinës në prill të vitit 2010 i kishte lënë të hapura të dyja mundësitë. Organi Shqyrtues i Prokurimit e kishte anuluar këtë tender duke kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të bëjë rivlerësimin e tij dhe të specifikojë kriteret në bazë të Ligjit të Prokurimit.

Komuna e Prishtinës ka përzgjedhur kompaninë "Plan Ing" nga Prishtina e cila do të paguhet afro 10 mijë euro për të bërë projektin e ndërtimit të një shkolle në fshatin Tenezhdoll. Kjo është bërë më 12 tetor të vitit 2010 sa për sy e faqe, pasi dy muaj më parë kishin filluar punimet për ndërtimin e kësaj shkolle. Punimet kishin nisur saktë më 4 gusht nga kompania "Rexha" dhe në ceremoninë e nisjes ishte prezent kryetari i Prishtinës, Isa Mustafa, ndërsa tenderi është shpallur shumë kohë më vonë.

MINISTRIA E DREJTËSISË DUHET TË PAGUAJ DËMSHPËRBLIM 80 MIJË EURO

Ministria e Drejtësisë vitin e kaluar kishte lidhur kontratë me kompaninë "Kaqandolli", e cila ishte shpallur fituese në tenderin për furnizim me vetura që e kishte shpallur ky autoritet. Oferta e kësaj kompanie për furnizim me 20 vetura kishte qenë mbi 200 mijë euro. Zyrtarët e kësaj ministrie e kishin shkëputur kontratën me këtë kompani me arsyetimin se ky operator ekonomik nuk i kishte përfillur specifikat e tenderit. Kjo kompani e kishte paditur në shtator të vitit të kaluar MD-nënë Gjykatën Ekonomike. Eksperti shqyrtues i kësaj gjykate në raportin e tij kishte konstatuar se kësaj kompanie duhet paguar 80 mijë euro dëmshpërblim për shkak të shkëputjes së njëanshme të kontratës. MD-ja pas shkëputjes së kontratës me këtë kompani e kishte hapur prapë tenderin. Kësaj ministrie i

ishin ndarë nga qeveria 230 mijë euro për blerjen e 20 veturave por me këto mjete ishin blerë vetëm 13 vetura nga kompania “Mercom” e cila ishte shpallur fitues në tenderin e dytë.

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE: PESËFISHIMI I NJË KONTRATE

Më 13 gusht të vitit të kaluar Ministria e Administratës Publike ka shpallur fitues të tenderit për menaxhimin e shpenzimeve të automjeteve qeveritare me sistemin GPS kompaninë “PBC” në konsorcium me “Navirecin” e Estonisë, pas ri-poentimit nga komisioni vlerësues i tenderit. Ky konsorcium ishte shpallur fitues për një lot (pjesë) të këtij tenderi që kishte të bënte me montimin e pajisjeve për 2 mijë e 500 veturave qeveritare, agjencive buxhetore dhe komunave. Oferta e kësaj kompanie kishte qenë 187 mijë e 500 euro, por sipas raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit kjo vlerë është pesëfishuar në momentit e nënshkrimit të kontratës nga Ministria e Administratës gjë që përbën shkelje të ligjit të prokurimit.

Përveç shkeljeve në prokurim, Lëvizja FOL konsideron se ky tender nuk do të duhej të ndodhte fare duke pasur në konsiderate nevoja të tjera shumë të rëndësishme ku afër 200 mijë euro mund të shpenzoheshin. Lëvizja FOL gjithashtu pyet Ministrinë e Administratës Publike nëse GPS e vendosur në vetura po funksionojnë?

KONTRATA E PALIGJSHME E ART-SË

Kryesuesi i Bordit Drejtues të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, Ekrem Hoxha, më 23 shkurt të vitit 2011 kishte marrë vendim që ta pushojë nga puna zyrtarin e lartë të prokurimit Avdi Ferin me arsyetimin se kishte bërë shkelje të rënda të detyrave të punës. Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtari i prokurimit kishte anuluar njoftimin për dhënie të kontratës e cila shpallte fitues konsorciumin R&T dhe TBS nga Shqipëria e cila ishte shpallur fitues në tenderin që kalonte shumën prej 830 mijë eurosh e që kishte të bënte me ndërtimin e qendrës nacionale të monitorimit të Radio Spektrit. Një gjë e tillë ishte kërkuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Në një shkresë të datës 18 shkurt Feri i kishte shpjeguar kreut të OSHP-së pse procesi kishte arritur deri në nivelin e shpalljes si fitues i këtij tenderi i konsorciumit nga Shqipëria. “Shpalljen e këtij njoftimi e ka bërë pasi kam qenë i lajthitur nga ana e kryetarit të Bordit të ART-së, i cili pas takimit që ka pasur me ju, më datë 16 shkurt, më ka urdhëruar që ta bëj njoftimin për dhënie të kontratës sipas procesit të rivlerësimit dhe se gjoja ju në këtë takim i keni thënë se njoftimi i datës 8 shkurt (për dërgimin e tenderin në rivlerësimin e dytë) nuk duhet të merret shumë seriozisht. Obligimi im ka qenë të bëjë shpalljen e fituesit sipas procesit të rivlerësimit”, thuhet në letrën e dërguar nga Feri, në adresë të kreut të OSHP-së, Hysni Hoxha. Më 3 mars OSHP-ja kishte marrë vendim përmes të cilit kishte dënuar bordin e ART-së me një shumë prej 30 mijë eurosh për shkak të shkeljeve ligjore.

“Autoriteti kontraktues (ART) për herë të dytë ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili ka ofruar tri oferta financiare, dhe një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit për Prokurim”, thuhet në vendimin e OSHP-së për shqiptimin e dënimit ndaj ART-së. Ndërkaq në deklaratën e tij për mediet zyrtari i prokurimit kishte deklaruar se

ka pasur presione nga bordi i ART-së që të shkelë ligjin dhe të shpërfill vendimin e OSHP-së dhe të mos e anulojë tenderin.

VËREJTJET E KOMISIONIT EVROPIAN DHE TË OSHP-SË NË FUSHËN E PROKURIMIT

Komisioni Evropian ka kritikuar përmbajtjen e ligjit të ri të prokurimit pasi sipas tyre përmbante disa nene të cilat nuk ishin në pajtim me kriteret e BE-së për fushën e kontratave publike. Sipas KE-së ligji i ri ashtu siç kishte rekomanduar ky institucion duhej të obligonte ministrin apo zyrtarin kryesor të një Autoriteti Kontraktues që të nënshkruante kontratat publike me vlerë të madhe. Po ashtu sipas KE-së ligji i ri lejon që dy ndërmarrjet publike KEK-u e PTK-ja të mos përfillin strikt ligjin e ri të prokurimit për shuma që nuk kalojnë shifrën prej 5 milionë eurosh. Kjo sipas Komisionit Evropian nuk është dashur të lejohej nga ligji i ri i prokurimit. Vërejtje e tjetër e KE-së ishte edhe që ky ligj të kishte amendamente që e rregullonin edhe fushën e koncesioneve. Përmbajtës së këtij ligji i ka dhënë edhe Organi Shqyrtues të Prokurimit. Sipas këtij institucioni kontratat publike duhet të nënshkruhen nga ministri, zyrtari autorizues dhe zyrtari i prokurimit. Po ashtu sipas OSHP-së ligji i ri duhej të rregullonte edhe fushën e shitjes së asetëve publike e koncesioneve. Ndërkaq, për sa i përket ecurisë së prokurimit publik në vend Raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2010 thekson se ky institucion ka pranuar 331 ankesa nga operatorët ekonomik të cilët kanë pretenduar se autoritetet kontraktuese e kanë shkelur ligjin e prokurimit gjatë përzgjedhjes së tenderuesve. Ky organ në 84 raste ka marrë vendim që Autoritet Kontraktuese që të bëjnë ri-vlerësimin e ofertave pasi kishin bërë gabime si pasojë e vlerësimeve të gabuara nga komisionet vlerësuese, duke hasur në shkeljet e të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik, gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave.

“Nga 331 rastet e shqyrtuara në 62 raste Paneli Shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit (Ri-tenderim), si pasojë e konstatimit të shkeljeve të dispozitave të LPP-së, për parregullsitë në dosjet e tenderit apo për zhvillimin me mangësi të procedurave të prokurimit”, thuhet në këtë raport. Sipas këtij raporti disa nga autoritet kontraktuese kanë qenë shpërfillur vendimet e OSHP-së e të cilat janë Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Ministria e Administratës Publike, Komuna e Prizrenit, Komuna e Gjakovës, Komuna Podujevës, Komuna e Gjilanit, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Policia e Kosovës, Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina”, Radio Televizioni i Kosovës dhe Postë-Telekomi i Kosovës-PTK. “Organi Shqyrtues i Prokurimit, në bazë të nenit 118 të LPP-së ka shqiptuar masën ndëshkuese për mosrespektimin e vendimit të Panelit Shqyrtues ndaj Autoritetit Kontraktues të Postë-Telekomit të Kosovës dhe menaxherit të prokurimit, kurse Autoritetet e tjera kontraktuese, pas urdhëresës së OSHP-së për shqiptimin e sanksioneve, kanë respektuar në tërësi vendimet e OSHP-së”, thuhet në këtë raport.

Agjencia e Prokurimit Publik gjatë viti 2010, ka ditur që t’ua prish planet për tenderë një burimorë institucioneve buxhetore. Të pakënaqura me vendimet e APP-së ato kanë parashtruar në OSHP kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve të APP-ës, apo ankesa të cilat kërkesa kanë të bëjnë me moslejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë apo revokim të nenit 30 A. 4 të LPP-ës, njohur ndryshe edhe si

tenderët një burimorë. OSHP gjatë viti 2010 ka shqyrtuar gjithsejtë 155 kërkesa të tilla. Nga to, 42 kërkesat e bëra nga Autoritetet Kontraktuese në OSHP, kanë të bëjnë me kërkesën për revokim të nenit 30A. 4, ku 33 prej tyre kërkesa janë aprovuar, kurse 9 të tjera janë refuzuar-nuk janë lejuar tenderët një burimorë.

95 kërkesa kanë pasur të bëjnë me lejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ku 72 prej tyre janë aprovuar e 23 të tjera janë refuzuar. OSHP-ja po ashtu gjatë vitit të kaluar ka pranuar 155 kërkesa të autoriteteve kontraktuese të cilat janë ankuar ndaj vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik që nuk i ka lejuar të përdor procedura të negociuar dhe njëburimore në përzgjedhjen e tenderuesve.

“Në përgjithësi, nga 155 kërkesa për shqyrtimin e vendimit të APP-se, 105 janë aprovuar nga OSHP-ja gjersa 32 kërkesa të shqyrtuara janë refuzuar nga Organi Shqyrtues të Prokurimit, për faktin se Panelet Shqyrtuese nuk kanë gjetur shkelje nga ana e APP-ës, dhe se vendimet e tyre kanë qenë të drejta dhe të bazuara në dispozitat e LPP-së”, thuhet në këtë raport.

REKOMANDIME

1. Lëvizja FOL rekomandon që Qeveria e Kosovës të marrë për bazë rekomandimet e Komisionit Evropian që Ligji i ri i Prokurimit publik të jetë në përputhje me kriteret e BE-së, ku aspiron edhe Kosova të jetë anëtare;
2. Lëvizja FOL i rekomandon Agjencisë Kundër Korrupsionit që rastet si këto të evidentuara nga Lëvizja FOL t'i përcjell me kujdes të shtuar edhe atëherë kur nuk ka ankesa nga ndonjë palë e interesit me qëllim të raportimit më kohë dhe shmangies së humbjeve të panevojshme;
3. Lëvizja FOL i rekomandon Prokurorisë së Shtetit që të nis hetimet lidhur me këto raste për të cilat ne mendojmë se ka shkelje të rënda të ligjit në mënyrë të qëllimshme;
4. Lëvizja FOL i rekomandon ZPP-ve që kompanitë që figurojnë në listën e zezë dhe ato që kanë mashtruar gjatë procesit të aplikimit për tenderë të ndryshëm të diskualifikohen nga mundësia për marrje të ndonjë tenderi përkatës;